



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr. 1213 Prot

Maliq, më 29.03.2022

Lënda: Prioritetet e komunitetit të Bashkisë Maliq në projekt buxhetin afatmesëm 2023 - 2025


Këshilli bashkiak në vijim të komunikimeve të mëhershme me bashkinë dhe në vijim të rezultateve të sondazhit të prioritetëve të komunitetit për vendosjen e tavaneve buxhetore për Projekt buxhetin Afatmesëm 2023-2025 ka vlerësuar prioritetet e komunitetit të cilat janë grumbulluar nëpërmjet një sondazhi të publikuar në faqen e KB në datën 15 shkurt 2022.

Vlerësimi i kërkesave të shprehura nga komuniteti ka ndjekur dy rrafshë:

C. Kërkesa / fushave me interes nga komuniteti të cilat duhet të buxhetohen nga bashkia

Rreth 14 fusha me interes nga komuniteti janë paraqitur si pjesë e sondazhit të realizuar nga KB me komunitetin. Në vijim bashkia mund të organizojë një tryezë teknike me komunitetin për të kuptuar më mirë nevojën e komunitetit në lidhje me kërkesat specifike që kanë drejtuar qytetarët ose duke organizuar takime të vecanta për to sipas tematikës.

Prioritet e publikut	Numri personave	Pesha në %
Papunesia, aftësim dhe punësim	42	20%
Sherbimet Bujqesore	28	14%
Kujdesi Social për personat e semurë dhe me aftësi të kufizuara	27	13%
Kujdesi Social për Familjet dhe Fëmijet	24	12%
Sport dhe Argetim	18	9%
Arsimi I Mesëm	16	8%
Strehimi	15	7%
Trashëgimia Kulturore	11	5%
Pjjet dhe Kullotat	7	3%
Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile	7	3%
Sigurimi Shoqëror	7	3%
Policia Vendore	4	2%



D. Fushat prioritare të shërbimeve që ofron bashkia, të cilat janë vlerësuar si ato funksione / shërbime që zënë një peshë të vogël në buxhetin e bashkisë si edhe kërkesa për të shpenzuar më shumë në ato shërbime që zënë një peshë të rëndësishme në buxhetin e bashkisë). Kini parasysh se kemi përzgjedhur si fusha prioritare ato ku shumica e personave që kanë marrë pjesë në sondazhin kanë sy gjeruar ato:

1	Papunesia, aftësim dhe punësim
2	Sherbimet Bujqesore
3	Kujdesi Social për personat e semurë dhe me aftësi të kufizuara



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

	kufizuara
4	Kujdesi Social per Familjet dhe Femijet
5	Sport dhe Argetim
6	Arsimi i Mesem
7	Strehimi
8	Arsimi bazë dhe parashkollori
9	Rrjeti rrugor

Ne kuadër të prioriteteve të tjera të paspecifikuara si fusha në sondazh komuniteti ka kërkuar si mëposhtë, të cilat thjesht janë kopjuar ashtu sikurse janë shkruar nga vetë qytetarët:

- Pyje dhe kullota
- Të rregullohet port - barazhi në kolektorin e Sovjanit pasi eshte jashtë funksionit. Të merren masa që kolektori i Sovjanit të ketë ujë për vaditje deri në fund të muajit Gusht
- Më shumë fonde për familjet në nevoje.
- Infrastrukturarrugore neper zonaturale dhe jo vetem ne ato urbane.

Në vijim të kësaj analize Këshilli Bashkiak i kërkon bashkisë të marrë në konsideratë prioritetet buxhetore të komunitetit për fushat e identifikuar si mësipër, për t'u bërë pjesë e shpërndarjes së tavanëve buxhetore sipas këtij prioriteti.

Një raport të detajuar të këtij sondazhi nga pjesëmarrësit përgjatë kësaj kohe e gjeni bashkëlidhur.

Me respekt

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

